

VENDIM
Nr.220, datë 25.5.1997

PËR MIRATIMIN E NJË GRUPI PROJEKTESH TË FINANCUARA NGA UNDP

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i masave të kontrollit kundër drogës”.

a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Brendshëm, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.

b) Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij projekti.

2. Miratimin e projektit “Dhënia e ndihmës së nevojshme Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e një masterplani në sistemin juridik”.

a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Drejtësisë, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.

b) Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij projekti.

3. Miratimin në parim të fazës së dytë të projektit “Partnerë në zhvillim”.

a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, ose i autorizuari i tij, për firmosjen e saj.

b) Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij projekti.

4. Miratimin e projektit “Përgatitja, formulimi, zbatimi dhe vlerësimi i projekteve për zhvillim”.

a) Miratohet marrëveshja e projektit dhe autorizohet drejtori i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe i Koordinimit të Ndhmës së Huaj për firmosjen e saj.

b) Për zbatimin e projektit ngarkohet Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe i Koordinimit të Ndhmës së Huaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino